



Pranuar / Dorezuar Prijemno/Prodato Received/Delivered	31. 01	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Hr Prot Br Prot	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMSHCK	419/2022		1/3	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.1011/2021**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Malësore Bajraktari Gashi, anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1011/2021 të datës 03.12.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Prishtinë, kundër organit të punësimit Agjencia Kadastrale e Kosovës, në çështjen juridike "Kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur me datë 31.01.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.1011/2021 e datës 06.12.2021, e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me datë 06.12.2021 ka parashtruar ankesë në formë elektronike me numër protokollit 5827/2021 të regjistruar me numër A.nr.1011/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes së datës 02.11.2021 të lëshuar nga Menaxherja e Personelit e Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 09.12.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencinë Kadastrale të Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 21.12.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Në mbështetje të nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe duke marr parasysh situatën e pandemisë me COVID-19 dhe punë me staf esencial, me Vendimin Nr.04/2022 të datës 20.01.2022 të Kryesuesit të KPMSHCK-së është

vazhduar afati për vendosje të ankesës me numër A1011/2021 të datës 06.12.2021 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 5827/2021 të regjistruar me numër A.nr.1011/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 06.12.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.12.2021; email i datës 02.11.2021 nga Menaxherja e Personelit të AKK-së për ankuesin, email i datës 18.11.2021 nga ankuesi për I.B dhe te tjerë, me emailat e bashkangjitur nga 1/5; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 6256/21 të datës 21.12.2021, Akt Emërimit të datës 30.12.2011; Rregulloren (QRK) NR.20/2014 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë Kadastrale të Kosovës, me Shkresën shtojca 1 Skema Organizative të AKK-së; Rregullore (QRK) NR.0.2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me Shkresën shtojca 1 Skema Organizative të Ministrisë-Kabineti politik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës, përkatësisht sipas Aktit të Emërimit të datës 30.12.2011, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i emëruar në pozitën e punës Ekspert i GIS-së, Sektori i Regjistrimit të Regjistrave në Drejtorinë për Gjeoinformacion, pranë Agjencisë Kadastrale të Kosovës.

Ankuesi me datë 29.09.2021 përmes e-mailit zyrtar i është drejtuar me kërkesë Zv. të Drejtoresh së Përgjithshme të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, që e njëjta në cilësinë e Udhëheqësit me të Lartë të AKK-së, të mundësoj që përmes lëvizjes brenda kategorisë apo ngritjes në detyrë të behët përzgjedhja e Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit të Adresave.

Me datë 02.11.2021, Menaxherja e Personelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës në përgjigje të kërkesës së ankuesit të datës 29.10.2021, ka njoftuar ankuesin se: *„në mungesë të buxhetit për këtë vit të kategoria e pagave dhe mëditjeve, na pamundësohet avancimi aktualisht. Po ashtu zv. Drejtoresha e përgjithshme e AKK-së, ka zhvilluar takime edhe me drejtorin e DMZP-së, i cili ne takim rekomandon se nuk mund te hapen konkurse nëse ka mungesë të buxhetit dhe se të njëjtat mund te konsiderohet të kontestueshme në mungesë të rregulloreve, kështu që me rastin e planifikimit të buxhetit të viti 2022 është kërkuar edhe buxhet për avancime dhe shpresojmë se të njëjtat do të mbulohen me buxhet për vitin 2022.“*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, pretendon që KPMSHCK të obligoj Agjencinë Kadastrale të Kosovës, që e njëjta ta ndryshoj Përgjigjen e datës 02.11.2021 të nxjerrë nga Menaxherja e Personelit të Agjencisë Kadastrale të Kosovës dhe të vendos në bazë të Ligjit për Zyrtarët Publik, aktet nënligjore, Ligjit Nr.04/L-071 për Sistemin e Adresave dhe Udhëzimit Administrativ Nr.16/2019 për Procedurat e Krijimit dhe Aministrimit të Regjistrimit Komunal të Adresave dhe Regjistrimit Shtetëror të Adresave, të bëjë zgjidhjen dhe emërimin e Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit të Adresave.

Kolegji, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk ka gjetur ndonjë akt që dëshmon se ankuesi ka qenë i autorizuar nga organi i punësimit të ushtroj detyrën e Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit të Adresave, ndërsa përkitazi me shqyrtimin e pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji në kuptim të dispozitave të nenit 15 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, konstaton se çdo institucion



bazuar në planin Vjetor të Personelit dhe planifikimin buxhetor, benë dhe plotësimin e vendeve të lira të punës, rrjedhimisht planifikimi i planit të personelit dhe zhvillimi i procedurave të rekrutimit të stafit mbetet çështje nën diskrecionin e institucionit përkatës, kështu që mbi këtë bazë Kolegji vlerëson së është i pa bazuar pretendimi ankimor që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të obligoj Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë Kadastrale të Kosovës që të zgjedhë dhe emëroj Udhëheqësin e Sektorit të Regjistrimit të Adresave.

Lidhur me plotësimin e pozitave të lira, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 38 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nga të cilat rezulton se plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. E nëse një pozita drejtuese e ulët dhe e mesme, nuk plotësohet sipas lëvizjes brenda kategorisë atëherë konkurrimi zhvillohet përmes procedurës së ngritjes në detyrë ashtu siç parashihet me nenin 39 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët publikë, ku theksohet se: *Nëse një pozitë e lirë e kategorisë së ulët apo e mesme drejtuese nuk është plotësuar sipas nenit 38 të këtij ligji, ajo hapet për procedurën e ngritjes në detyrë...."*

Po ashtu, bazuar në nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike, ku përcaktohet se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vlerëson se me mos veprimin e organit të punësimit gjegjësisht Agjencisë Kadastrale të Kosovës lidhur me mos plotësimin e pozitës së punës se Udhëheqësit të Sektorit të Regjistrimit të Adresave, nuk është cenuar ndonjë e drejtë e ankuesit përkitazi me marrëdhënien e tij të punës, kështu që bazuar ne rrethanat si me lart, dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1011/2021.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetarja e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit
- Zëvendës Drejtores së Përgjithshme në Agjencinë Kadastrale të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës dhe
- Arkivot të KPMSHC-së.